

**STATUTI I SHOQERISE  
“DIDA & AD” SH.P.K**

**Kreu I**  
**Themelimi,Emri,Objekti,Kohëzgjatja,Selia**

**Neni1:**  
**Data e Themelimit,Emri dhe Themeluesit**

- (1) Sot,më date 01.11.2019,u n e ,themeluesi Ortak i Vetem,kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“DIDA & AD” SH.P.K**
- (2) Themeluesi i shoqërisë eshte Denis DIDA , I datelindjes 29.03.1980 lindur ne Diber dhe Banues ne Durres ,madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar , me numer identifikimi I00329193C .

**Neni2:**  
**Objekti**

Shoqëriadotë kryejëaktivitetine mëposhtëm:  
1.Tregeti me pakice dhe shumice te artikujve elektrike,hidrosanitare, dhe te materialeve te ndertimit, import-eksporti i tyre.  
2.Punime elektrike dhe hidraulike,montimi i paisjeve te ketij lloji.

**Neni3:**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afate.

**Neni4:**  
**Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Zona Kadastrale 3542 ,Godina nr.1, kat i pare ,Sukth I Ri , DURRES.
- (2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë:didadenis@icoloud.com
- (3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:didadenis@icoloud.com

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni5**  
**Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestari I shoqërisë është 100.000 (Njeqinmij) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku vete **Denis DIDA** zotueresi 100 (Njeqind) ne një kuote te vetme me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njeqind mij) Leke që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni6:

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributiveve në natyrë, nepermjet vendimit te Ortakut te Vetem.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet me vendim te Ortakut te Vetem, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.

#### Neni7

##### Transferim I ikapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen a po kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesë te kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### KREU III

##### ORGANET VENDIMMARRE SEDH DREJTUESE

#### Neni8 Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton edo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështje te më poshtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin I likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimine kapitalit;
- f) pjesëtimine kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**Neni9  
Administratori**

- (1) Ortaku i vetem emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Q.K.R.
- (2) Detyra e Administratorit te vetem i caktohet z.Denis DIDA me numer identifikimi 100329193C

**Neni10  
Kompetencat Administratorit.**

Administratori kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura Ortaku i vetem;
- b) Përfaqësojnë shoqerinëtregtare;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- ç) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortaku i vetem për miratim;
- d) Krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Raportojnë përpara Ortaku te vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare;
- ë) Kryejnë detyrat ë tjetra të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratoret janë te detyruar te njoftojen Ortakun e Vetem, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor a raporaporteve të ndërmjetme financiare, rezulton se ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë a po të disponojë në mënyrë tjetë raktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Ortaku i Vetem mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.
- Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 11 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, përshkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë. I ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përfundit me mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryej detyrate tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;

b) të ushtroj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësoj me përgjegjësi çështjet, përfundit me merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtroj detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë përfundit me mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që atë apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të pa rregullta. Administratori ka barren e proves përfundit

vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit,, Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprime te mëposhtme:

a) U kthen ortakëve kontributet;

b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) U shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë-të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Ortaku te vetem nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesëpadisë kundëra dministratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KreuIV Viti finanziar-ekspertet**

##### **Neni 12**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga datae regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 13 Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaqit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### **KreuV Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni14**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) Ku mbarton kohëzgjatja e parashikuar në themelimin esaj;
- b) me vendim të Ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem. Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin elikuiduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’l drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni15**  
**Riorganizmi I shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni16**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Persa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

**Neni17**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin a po interpretimine ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DIDA & AD” SH.P.K.**

**DENIS DIDA**

